



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.06.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 4.06.2018 dhe 5.06.2018.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 11 qershor 2018 – 6 korrik 2018.

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Nuri Belba, Arben Kamami, Roland Xhelilaj Floida Kërpaçi dhe Nora Malaj.

Mungojnë:

Bardh Spahia, Vangjel Tavo, Grida Shqina, Halim Kosova, Orjola Pampuri dhe Lindita Metaliaj.

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Përshëndetje!

Siç është planifikuar, në mbledhjen e sotme kemi miratimin e kalendarit të punës së komisionit. Të gjithë keni qenë të njohur me draftin paraprakisht, keni ndonjë sugjerim apo kërkesë për ndryshim?

Roland Xhelilaj – I vetmi opinion që ne kemi në lidhje me mbledhjen për shqyrtimin në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar”, e cila është planifikuar të zhvillohet të bëhet me datë 13 qershor, të mund të shtyhet në një datë tjetër. Mund të bëhet në një kohë me shqyrtimin nën për nën dhe për nesër të mos kemi mbledhje.

Petrit Vasili – Jo, në një kohë nuk mund të bëhen. Por nëse keni ndonjë sugjerim për datë?

Roland Xhelilaj – Ne nuk e kemi të mundur pjesëmarrjen nesër.

Petrit Vasili – Mirë, nesër nuk e bëjmë mbledhjen. Nëse nuk kemi sugjerime për ndryshime të tjera, do ta shikojmë se ku do ta akomodojmë këtë mbledhje dhe biem dakord në parim, duke parë edhe gatishmërinë e njëri – tjetrit, në varësi edhe të impenjimeve.

Kemi ndonjë gjë tjetër për sa i përket çështjeve që janë në kalendar?

Atëherë, kush është dakord me këtë kalendar? Dakord.

Miratohet.

Nesër nuk do të zhvillojmë mbledhje, siç e lamë, dhe do të shikojmë për data të tjera.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA